

NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA

BASHKIA LEZHË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “SIRETA 2F” SHPK & “AGRI
CONSTRUCTION” SHPK & “CARA” SHPK, ME ADRESE LAGJIA “BABRRU FUSHE”,
KOMUNA PASKUQAN , PASKUQAN KODER, TIRANE

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “UDHA” SHPK & “NDREGJONI” SHPK, ME
ADRESE LAGJIA “PJETER BUDI”, BURREL

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Pershpejtuar Rindertimi”, E Kufizuar/ Pune, Marrëveshje
Kuadër”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-83518-12-30-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksioni i mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa
ne ndertesat pallat, te prekura nga Termeti i dates 26.11.2019, ne Bashkine Lezhe”.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 Muaj nga data e nënshkrimit te marrëveshjes Kuader.

Kohëzgjatja e parashikuar e kontratës: Do të jetë deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj nga momenti i lidhjes
se kontrates ose me afat me të shkurtër në varësi të veçantisë godinave.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të
ofruara:

1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SIRETA 2F” Shpk, me Nuis K51501008J & “AGRI
CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis K01725001F & “CARA” Shpk, me Nuis K07729920F.

2- Bashkimi I Operatoreve Ekonomik “UDHA” Shpk, me Nuis K77524909Q & “NDREGJONI”
Shpk, me Nuis K31329048I.

3- Operatori Ekonomik “ULZA” Shpk, me Nuis J67902928O.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1- Operatori Ekonomik “ULZA” Shpk, me Nuis J67902928O.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik “ULZA” Shpk, me Nuis J679029280.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari ne piken 2.2.4 parashikohet se: Operatori Ekonomik duhet te kete pjese te stafit teknik te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise: Inxhinier Ndërtimi 2 (dy); Arkitekt 2 (dy); Inxhinier Elektrik 1 (nje); Inxhinier Elektronik 1 (nje); Inxhinier Hidroteknik 1 (nje); Ing Mjedisi 1 (nje).

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, konstatohet se OE nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar disponueshmerine ne stafin etij teknik dhe nuk figurojnë ne Liçencen e shoqërisë 1 inxhinier Ndertimi, 2 Arkitektet dhe Inxhinieri Elektronik.

Se dyti ne piken 2.2.5/a parashikohet se: Operatori ekonomik duhet të ketë staf mbështetes të punësuar punonjesit e meposhtem:

a) Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te pakten 2 (dy) Teknik Ndertimi, 1 (nje) teknik gjeodet te certifikuar per te cilet duhet te paraqese kontraten e punes te vlefshme, diplome, dhe te jete ne listepagesat e shoqerise te pakten muajin e fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, konstatohet se OE nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar disponueshmerine ne stafin e tij mbështetës te 1 tekniku Gjeodet i cili duhet te ishte i pajisur me Diplome te Shkolles se Mesme per gjeodezi.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit” vendosi te refuzoje oferten e OE “ULZA” Shpk, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. të ndryshuar, OE “ULZA” Shpk, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SIRETA 2F” Shpk, me Nuis K51501008J & “AGRI CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis K01725001F & “CARA” Shpk, me Nuis K07729920F.

2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “UDHA” Shpk, me Nuis K77524909Q & “NDREGJONI” Shpk, me Nuis K31329048I.

Shënim: Referuar VKM nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkise Lezhe, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 22.01.2021

Ankesa: Nuk Ka